REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNAL - LIPJAN
DREJTORATI I INSPEKTORATIT

DREJTORIJA E INSPEKTORATIT

Datë :	**02.04.2021**
Referencë	**11-344/3**
Për :	**Imri Ahmeti-Kryetar i Komunës**
Kopje:	**Fauz Xhemajli-Nënkryetar i Komunës**
Kopje:	**Lulëzim Qerimi-Nënkryetar i Komunës**
Nga:	**Imer Rrustemi- Drejtori i Inspektoratit**
Lënda :	**Raporti i muajit-mars**

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E RAPORTIMIT

Edhe gjatë muajit mars për inspektoratin prioritet ka qenë Pandemia dhe menaxhimi i saj.
Jemi bazuar në bazë të udhëzimeve të M.SH në bazë të vendimeve të lëshuara nga kjo Ministri. Për respektimin e masave për mbrojtje nga sars-cov-2 virusi si dhe në bazë të ligjit 07/L-006 për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë covid-19.
Në përgjithësi i kemi inspektuar:
a. Qendrat tregtare
b. Supermarkete me produkte ushqimore dhe jo ushqimore
c. Gastronominë
ç. Trsaportuesit publik
d. Auto-taksitë
dh. Furrat e bukës
e. Barnatoret humane

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE

Gjatë tërë muajit mars në koordinim me QKMF-në e Lipjanit dhe Policin e Lipjanit duke i monitoruar rastet me covid-19. Për pos pandemisë e kemi pas në agjendë edhe sigurinë ushqimore, duke i përcjellë në çdo supermarket kushtet e ruajtjes së produkteve ushqimore.
Në veçanti kujdes ju kemi kushtuar ruajtjes së ushqimit qumështit dhe mishit si dhe produkteve të tyre meqë këto dy produkte janë mjaftë të ndishme në ruajtjen e temperaturave. Ato produkte ku gjatë ruajtjes nuk janë të përshtatura me dekleracione tyre i kemi asgjësuar ngase janë produkteve ushqimore të dyshimta dhe jo të sigurta për konsum. Një kompani ka bërë kërkesë për asgjësim të mallit të dëmtuar nga disa pika shitëse kështu ju kemi përgjigj mallin ja kemi asgjësuar në prezencë të ATK. Vlera e asgjësimit ishte 19.635.44 €.
Në bazë të listave që vijnë nga Instituti Kombëtar Shëndetit Publik të Republikës së Kosovës si dhe listës së QKM-së në Lipjan ju kemi përgatitur vendimet pacientëve që kanë rezultuar pozitiv për vetizolim. Njëkosisht edhe personave të shëruar në bazë të njoftimit të IKSHPK-së ju kemi shfuqizuar vendimet e më parshme të izolimit dhe ju kemi dërguar vendimet për raste të ndryshme për punë e raste tjera që janë të lirë me dalë si qytetarë të lirë.
Të gjitha bizneset gjatë muajit mars kanë qenë nën kontroll të vazhdueshëm të inspektimit dhe menaxhimit.
Ju kemi përgjigjur edhe kërkesave të ndryshme të qytetarëve për çdo rast brenda jave .
I kemi përcjellë edhe çmimet në bazë të ofertave që kishim bërë zbritje kompanitë e ndryshme. Në muajin mars nuk kemi hasë kompani që i ka mashtruar konsumatorët.

STATISTIKAT

Inspektorët	Gjithsej inspektime	Inspektime me procesverbal	Pranime teknik	Fletëparaqitje	Inspektime për pirjen e duhanit	Kallëzim penal	Pëlqime sanitare	Vërejtje, njoftime	Mbyllje e përkohshme e lokaleve	Të hyra nga pranimet teknike	Vendime për vetë izolim dhe vendime për shfuqizim të vetë izolimit	Punë me palë, ankesa , kërkesa	Lendet e pranuara	Lende te pezulluara, ekzekutuara gjygjesore	Gioba mandatore	Ins. Te biznesve për vendosjen e flamujve afër artikujve	Biznese të paregjistruara dhe pa pranime teknike	Ins. I biznesve se sa i respektojnë vendimet e Qeverisë për parandalimin e virusit Covid-19	Ins. I kafshëve në thertore	Menaxhim I tregjeve	Aktvendime, ndalesa, urdhëresa, vendime	Inspektim me polici	Persona të vdekur nga covid-19	Asgjësim malli me terkes e një kompanie
Biznesi	177	39	12							300€		67					30			8	21			
Ambienti	17	15		1											1									
Sanitarët	964	23					2				825	3			1			105					5	19,635,44€
Bujqësia	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/
Ndërtimi	43	31		1								5									6			
Trafiku	114	46		3				25				18	2							10		10		
Gjithsej	1315	154	12	5			2	25		300€	825	93	2		2		30	105		18	27	10	5	19,635,44€

DISKUTIMET PUBLIKE

Për arsyeje të pandemisë dhe rritjes të numrit të qytetarëve me covid-19, nuk kemi mbajt takime me publikun.

TAKIME TË TJERA

Takime kemi mbajt me biznese dhe qytetar për ndonjë rast që kanë pasur, por vetëm një nga një.

SFIDAT

Për inspektoratin sfidë kryesore mbetet pandemia. Mbesim me shpresë edhe qytetarët tanë të vaksinohen dhe të trajtohen barabartë si shtetet tjera.

REKOMANDIMET

Rekomandojmë qytetarët e Komunës sonë që të t'ju përmbahen rekomandimeve të IKSHPK-së si dhe urdhëresës së M.SH të Republikës së Kosovës.